



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI

P/VEEDIM

Nr. 09 date 10.03.2025

“PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E
ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2025 NË TERRITORIN
ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni.30 pika.4, shkronja.c ; ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”; VKM-ne nr.134 datë 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 datë 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” të ndryshuar, si dhe referuar Shkreses Nr.70/ Prot datë 07.03.2024 “Dërgim për miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje dhe kullota për vitin 2025” nga nga DAPK, Sektori Emergjencave Civile dhe MZSH, Bashkia Fushe-Arrëz drejtuar Keshillit Bashkiak Fushe-Arrëz ndaj:

- I propozojmë Këshillit miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje dhe kullota për vitin 2025.
- Bashkëlidhur këtij janë Plani i Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarrëve në pyje dhe kullota për vitin 2025 dhe Skema e ndërlidhjes.

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

DREJTORI
ARDMIR DODA

KRYETARI

Hil CURRI

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PËRGJEGJESI
DOD BEPA

SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH

KOMONDANTI
ALFRED QAFI

JURISTI

Redona HASANI

KRYETARI I KËSHILLIT

Nikolin BARDHOKU



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE
M.N.Z.SH

Nr. 737 Prot



Fushë-Arrëz më 10 / 03 / 2025


RELACOIN

“PËR

MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE SHUARJEN E ZJARREVE NË PYJE DHE KULLOTA PËR VITIN 2025 NË TERRITORIN ADMINISTRATIV TË BASHKISË FUSHË-ARRËZ”

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet”, neni.30, pika.4, shkronja.c ; ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”; VKM-ne nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 date 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” të ndryshuar, si dhe referuar Shkreses Nr.707 Prot datë 07.03.2024 “Dërgim për miratimin e Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025”, nga DAPK, Sektori Emergjencave Civile dhe MZSH, Bashkia Fushë-Arrëz hartuan relacion shpjegues sipas dokumentave bashkëlidhur:

- Planit të Masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota për vitin 2025.
- Skema e ndërlidhjes.



DREJTORI DAPK
ARDMIR DODA

PËRGJEGJESI I SEK TË EMERGJENCAVE CIVILE

DOD PEPA

KOMONDANTI MZSH

ALFRED QAFA

Juristi: Redona HASANI

KRYETARI
HIL CURI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

M.Z.SH



PLAN - MASASH

Në kuader të marrjes së masave për parandalimin e rënjes së zjarrëve në pyje dhe kullota në territorin administrativ të Bashkisë Fushë-Arrëz, Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave për vitin 2025 hartoj planin e masave paraprahe për mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave nga zjarret në bashkëpunim me sektorin e Emergjencave Civile dhe M.Z.SH si më poshtë:


1. Organizimi i takimeve me banoret e të gjithë Njësive Administrative të Bashkisë Fushë-Arrëz për domosdoshmërinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret (Mars - Prill 2025).
2. Përpilimin dhe shpërndarjen për çdo Nj. Administrative dhe fshat të formularëve të skuadrave të M.Z.SH-së, instruktimit të këtyre skuadrave të zjarrëfikseve të fshatit (Mars-15 Maj 2025).
3. Organizimi i mbledhjëve nga Kryetarët e fshatërave me të gjithë banorët, krijimi i skuadrave zjarrfikse dhe vrojtuese dhe vrojtuesëve ditor të fshatërave (deri në 15 Prill 2025).
4. Krijimi i skuadrave zjarrëfikse, sjellja e listave me emrat e skuadrave pranë Seksionit të Pyjeve për secilin fshat (deri në 15 Maj 2025).
5. Evidentimi dhe mbajtja në vëzhgim të përhershëm të zonave të rrezikuara me rrezikshmeri të lartë për zjarre (Maj 2025 e në vazhdimësi).
6. Njoftimi në kohë të shpejtë e rënjes së zjarrit dhe marrja në kohë e masave për izolimin e tij (gjatë gjithë kohës).
7. Përpilimi i dokumentacionit të nevojshëm për zjarret, dhënia e menjëhershme e informacioneve organeve përgjegjëse (vazhdimisht).
8. Për parandalimin e zjarrëve në pyje do të bashkëpunohet me të gjithë aktorët privat dhe shtetëror që operojnë në Bashkinë e Fushë-Arrëzit (vazhdimisht).
9. Në çdo rastë nevojë do të kërkohet edhe ndihma e të gjithë insuticionëve të Qendrave Shëndetësore dhe Arsimore që janë në territorin e Bashkisë (vazhdimisht).
10. Do të bashkëpunohet ngushtë me median lokale e kombetare, vizive dhe të shkruar për ndërgjegjësimin e komunitetit për parandalimin e zjarrëve në pyje (Korrik 2024).
11. Do të përdorim Togëfjalshin "MBRONI PYJET NGA ZJARRET" dhe "PYJET JANE PASURI E JONË" si mbishkrime në vende të dukshme për sensibilizimin e komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret.

Faleminderit për mirëkuptimin.

DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

DREJTORI

ARDMIR DODA



SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE

PËRGJEGJESI

DOD PEPA

SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH

KOMONDANTI

ALFRED Oafa






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE



SKEMA E NDËRLIDHJES PËR MONITORIMIN E ZJARREVE NË PYJE GJATË
VITIT 2025



DREJTORI
ARDMIR DODA

